

Korrik – Gusht 2012

PERMBAJTJA

Faqe 1

Peticion: “Kërkojmë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës që të publikojë emrat e zyrtarëve të cilët janë gjetur fajtor për korrupsion dhe sjellje tjera të pahijshme”

Faqe 2

ATRC kontribuon në ngritjen e kapaciteteve të grupeve avokuese joformale në katër komuna të regjionit të Gjilanit

Faqe 3

Trajnim i përkrahur nga IOM

Trajnime/Punëtori për organizatat joqeveritare

Faqe 4

Funksionimi i nën-strukturave komunale që janë në shërbim të qytetarëve

Faqe 5

Rreth ATRC-se

PETICION: “KËRKOJMË NGA KËSHILLI GJYQËSOR DHE KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS QË TË PUBLIKOJ EMRAT E ZYRTARËVE TË CILËT JANË GJETUR FAJTOR PËR KORRUPSION DHE SJELLJE TJERA TË PAHIJSHME”

Kampanja Drejtësia dhe Qytetarët, e koordinuar ATRC dhe në partneritet me Qendrën për Ndihmë Juridike, Zhvillim Rajonal (CLARD), dhe Sejdiu dhe Qerkinit, G.P. me mbështetje nga Public International Law and Policy Group (PILPG), gjatë muajit shtator filloi aksionin për mbledhjen e nënshkrimeve nga qytetarët duke kërkuar nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës që të publikohen emrat e zyrtarëve, të cilët janë gjetur fajtor për korrupsion dhe sjellje të pahijshme.

Peticioni u zhvilluar në qendër të Prishtinës, më 26, 27 dhe 28 shtator. Gjatë këtyre ditëve peticionin e nënshkruan mbi 1 200 qytetarë.

Kampanja Drejtësia dhe Qytetarët do të vazhdojë me organizimin e aktiviteteve të ndryshme, me qëllim që t’i informoj qytetarët në lidhje me punën, angazhimet dhe sfidat e sistemit gjyqësor në përgjithësi si dhe të rritjes së përgjegjshmërisë së sistemit të drejtësisë karshi qytetarëve.



Informatori: **The Advocate**, është publikim tremujor i ATRC-së, i cili synon të informojë organizatat joqeveritare, donatorët, mediat, përfaqësuesit e institucioneve etj, për aktivitetet e zhvilluara në ATRC dhe nga partnerët e saj. Shpresojmë dhe urojmë që publikimi do të jetë në funksion të informimit dhe koordinimit më të mirë të aktiviteteve në mes ATRC-së dhe organizatave të tjera joqeveritare në Kosovë. Publikimi është bërë i mundur falë gatishmërisë dhe vullnetit të stafit të ATRC-së.

ATRC KONTRIBUON NË NGRITJEN E KAPACITETEVE TË GRUPEVE AVOKUESE JOFORMALE NË KATËR KOMUNA TË REGJIONIT TË GJILANIT

ATRC ka vazhduar të kontribuoj në ngritjen e kapaciteteve të grupeve avokuese joformale, të cilat janë themeluar nga ATRC. Gjatë këtij tremujori janë zhvilluar një sërë takimesh dhe punëtori me 20 grupet avokuese të komunës së Gjilanit, Vitisë, Kamenicës dhe Novobërdës. Qëllimi i përkrahjes së këtyre grupeve është ngritja e kapaciteteve avokuese të qytetarëve në inicimin e praktikave të qëndrueshme dhe efektive në mes qytetarëve dhe komunave të tyre. Këto aktivitete janë pjesë e projektit “Qytetarë aktiv-komuna të përgjegjshme dhe transparente”, i përkrahur nga Olof Palme International Center.

Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, gjatë kësaj periudhe ATRC ka zhvilluar edhe takime me zyrtarët e komunave të lartpërmendura. Gjithashtu, me përkrahje nga Olof Palme International Center është zhvilluar edhe një vizitë studimore në Suedi. Në këtë vizitë studimore morën pjesë Drejtori i ATRC-së z.Kushtrim Kaloshi dhe Drejtori i Drejtorisë për buxhet dhe financa i Komunës së Gjilanit z. Nuhi Nuhiu. Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i eksperiencave rreth përfshirjes së qytetarëve në qeverisjen lokale.



TRAJNIM I PËRKRAHUR NGA IOM

ATRC me përkrahje nga International Organization for Migration (IOM) gjatë muajit korrik ka mbajtur trajnimin "Avokimi dhe Ngritja e Fondeve". Pjesëmarrëse në trajnim ishin përfaqësueset e Organizatave joqeveritare të Strehimoreve të Kosovës.

Trajnimi kishte për qëllim zhvillimin e shkathtësive avokuese dhe fuqizimin e Koalicionit të Strehimoreve të Kosovës (KSC) për punë efektive avokuese.

Punëtorja iu mundësoi pjesëmarrëseve të kuptojnë procesin avokues dhe ndikimin në politikat publike, identifikimin e çështjeve dhe objektivave të përbashkëta si dhe përzgjedhjen e strategjive efektive avokuese. Pjesëmarrëseve iu dhanë edhe këshilla praktike se si organizatat anëtare të Koalicionit mund të zhvillojnë fushata të suksesshme avokimi për çështje të caktuara dhe të arrijnë rezultatin e synuar.

TRAJNIME/PUNËTORI PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE

ATRC gjatë muajit shtator ka mbajtur 3 trajnime, për organizatat joqeveritare RAE të komunës së Ferizajit.

Qëllimi i organizimit të këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve të OJQ-ve RAE në fushën e avokimit. Punëtoritë janë përqëndruar në ofrimin e metodave dhe praktikave të nevojshme për dizajnim dhe menaxhim të suksesshëm të fushatave avokuese. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit identifikuan të gjitha hapat e procesit të avokimit, duke filluar nga identifikimi i çështjeve avokuese dhe deri tek përcaktimi i strategjive dhe hapave konkret që do t'i ndërmarrin organizatat.

Si rezultat, organizatat pjesëmarrëse zhvilluan planin detaj të fushatës avokuese, për implementimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

FUNKSIONIMI I NËNSTRUKTURAVE KOMUNALE QË JANË NË SHËRBIM TË QYTETARËVE

Në kuadër të projektit “Mekanizmat për qytetari aktive”, të përkrahur nga The Balkan Trust for Democracy, ATRC ka analizuar funksionimin e nënstrukturave komunale që janë në shërbim të qytetarëve. Në këtë vlerësim janë përfshirë 33 komuna të Kosovës: Prishtina, Prizreni, Gjakova, Peja, Gjilani, Mitrovica, Ferizaji, Suhareka, Deçani, Drenasi, Kamenica, Istogu, Skenderaj, Rahoveci, Malisheva, Lipjani, Dragashi, Vushtrria, Kaçaniku, Vitia, Shtime, Klina, Obiliqi, Fushë Kosova, Podujeva, Hani i Elezit, Juniku, Novobërda, Mamusha, Kllokoti, Graçanica, Shtërpce dhe Ranilluga.

ATRC, përmes këtij vlerësimi ka synuar të siguroj informata për organizimin territorial të komunave, përkatësisht mënyrën e funksionimit të Bashkësive Lokale, Bashkësive Territoriale, Zyrave të Vendit, Këshillave të Fshatrave etj.

Nga vlerësimi del se vetëm komuna e Prishtinës, Prizrenit, Gjakovës, Kamenicës, Mitrovicës, Drenasit, Skenderajt kanë të themeluara dhe funksionale Bashkësitë Lokale, kurse komuna e Pejës ka të themeluara Bashkësi Teritoriale.

Ndër arsyt kryesore për mosfunksionimin e Bashkësive lokale në komunat tjera janë mosobligimi ligjor për themelimin e tyre dhe mungesa e mjeteve financiare. Në këtë mënyrë komunat e Kosovës vazhdojnë me forma dhe praktika të ndryshme të organizimit territorial.

Ndërkohë, shumica e komunave të Kosovës e shohin të domosdoshme themelimin ose rifunksionalizimin e nënstrukturave komunale në shërbim të qytetarëve. Sipas tyre, Bashkësitë lokale konsiderohen si një ndër mekanizmat shumë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve më të shpejta dhe më efikase për qytetarët. Gjithashtu, themelimi ose rifunksionalizimi i BL-ve konsiderohet si një ndër hallkat e rëndësishme të komunikimit të qytetarëve me zyrtarët komunal si dhe mjet efikas në informimin e qytetarëve rreth çështjeve të ndryshme.

MISIONI I ATRC-së

ATRC është organizatë kosovare, jo-ftimprurëse e cila synon rritjen e pjesëmarrjes së qytetareve në përgjithësi dhe shoqërisë civile në veçanti në proceset vendimmarrëse përmes ofrimit të shërbimeve dhe bashkëpunimit aktiv me palët me interes në vend dhe jashtë tij si një nga kushtet themelore për një shoqëri të zhvilluar dhe demokratike.

PROGRAMET KRYESORE TË ATRC

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të rrisë kapacitetet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit të përgjithshëm organizativ, menaxhimit të projekteve, zhvillim të fushatave të suksesshme të avokimit etj.
2. Programi i administrimit të granteve, i cili synon të ndihmojë organizatat joqeveritare lokale përmes granteve të vogla kryesisht në fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional.
3. Programi për Avokim, përmes projekteve të ndryshme ATRC synon të avokojë në institucione nacionale dhe lokale për probleme të ndryshme të cilat janë preokupim dhe brengë e qytetarëve në përgjithësi.
4. Informimi, përmes të cilit ATRC synon të ofrojë informacione në mënyrë elektronike në ueb faqe, në lidhje me diskutimet publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ndërtimet e koalicioneve, ndërmjetësim partneriteti dhe bashkëpunimi. ATRC, gjithashtu në kuadër të kësaj komponente ofron librari me 1756 tituj të ndryshëm, si: botime për çështjet sociale, politike dhe ekonomike që lidhen me Kosovën dhe rajonin, analiza, studime, hulumtime dhe dokumente tjera me rëndësi mbi fushëveprimtarinë e organizatave joqeveritare në përgjithësi, të krijuara nga organizata joqeveritare brenda dhe jashtë Kosovës.

ADVOCACY TRAINING & RESOURCE CENTER - ATRC

Rr. GAZMEND ZAJMI NR.20 PRISHTINË,

PHONE/FAX: +381(0)38 244810

E-MAIL: info@advocacy-center.org

web page: www.advocacy-center.org